



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 566/2 prot.

Tiranë, më 30.04.2025

V E N D I M

Nr. 104 , datë 30 . 04 . 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 77, datë 01.04.2025, të paraqitur nga z. K. H., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Fier në të cilën pretendohet për diskriminim të djalit të tij, z. G. H., për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, z. K. H., parashtron si vijon: “Unë, z. K. H., babai i G. H., banues në fshatin Kafaraj të Qarkut Fier, dëshiroj të paraqes këtë ankesë në emër të djalit tim (PAK), lidhur me një padrejtësi të pësuar për shkak të vonesave burokratike në përpunimin dhe delegimin e dosjes së KEMPI-t të djalit. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, VKM Nr. 736, datë 27.11.2024, të gjithë personat me aftësi të kufizuara (PAK) kanë përfituar një pagesë shtesë (bonus) në muajin dhjetor. Megjithatë, për shkak të vonesës në përpunimin/delegimin e dosjes, pagesa e KEMP-it u ndërpre, duke bërë që të humbas automatikisht të drejtën për këtë bonus.

Për të përfituar shpërblimin prej 150 eurosh, të miratuar nga qeveria shqiptare në dhjetor 2024, personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe kategoritë e tjera të përfshira në vendim duhet të ishin përfitues ekzistues të skemave të mbrojtjes sociale deri në atë periudhë. Ky shpërblim u akordua automatikisht për këto kategori, duke përfshirë familjet në nevojë, fëmijët pa kujdes prindëror dhe kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara. Djali im ishte pjesë e skemës në mënyrë të pandërprerë; kjo nënkupton që pagesa e KEMP-it u krye edhe në dhjetor (që ishte kusht për përfitimin e bonusit), por për shkak se vendimi i biopsikosocialit postohet me vonesë në Njësinë Administrative Frakull e Madhe nga DRSHSSH-ja (ka mbërritur pas datës 10 dhjetor 2024), u bë shkak në mos përfitimin e bonusit.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Dua të theksoj se kjo situatë nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë faji apo neglizhence nga ana ime, por ekskluzivisht për shkak të procedurave administrative, të cilat nuk kanë respektuar afatet dhe më kanë penalizuar padrejtësisht. Kjo më ka shkaktuar vështirësi të konsiderueshme financiare dhe ka përbërë një trajtim të pabarabartë ndaj meje në krahasim me përfituesit e tjerë.

Për këtë arsye, ju kërkoj të ndërhyjni për të garantuar që unë dhe të gjithë personat në situatën time të mos penalizohemi për shkak të vonësive administrative, dhe të na sigurohet e drejta për të marrë bonusin e dhjetorit, ashtu siç është parashikuar nga ligji.

Në pritje të një shqyrtimi të drejtë të kësaj çështjeje dhe një zgjidhjeje sa më të shpejtë, ju falënderoj për vëmendjen dhe përkushtimin tuaj.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bonusit të dhjetorit si person me aftësi të kufizuara.

- Pas depozitimit nëpërmjet Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fier, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, lidhur me legjitimitetin si palë në procedurën administrative pranë Komisionerit.
- Për këtë arsye, nëpërmjet komunikimit telefonik në numrin e vendosur në formularin e ankesës, nga ana e Drejtorisë së Hetimit Administrativ/KMD, është tentuar të kontaktohet me z.K. H. për t'i kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionerit një deklaratë përfaqësimi për djalin e tij shtetasin, z. G. H., por numri ka rezultuar i fikur.
- Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr.566/1 prot., datë 07.04.2025 të Komisionerit i është kërkuar plotësimi i ankesës me informacionin si mëposht:
 - Aktin e përfaqësimit që keni tagrin ligjor për të përfaqësuar djalin tuaj në këtë shqyrtim administrativ.
 - Informacion nëse djali i tij ka humbur zotësinë për të vepruar dhe ai është caktuar përfaqësuesi ligjor, të depozitohet dokumenti përmes së cilit vërtetohet që ai është caktuar përfaqësuesi ligjor i të birit.
 - Informacion nëse ka paraqitur ankesë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier; nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
 - Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do ta gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.
- Sipas Fletës së Lajmërim-Marrjes së Zyrës Postare nr. RR 765 487 630 AA, datë 07.04.2025, rezulton se ankuesi ka marrë në dorëzim shkresën nr. 566/1 prot., datë 07.04.2025, të Komisionerit, por nuk ka paraqitur asnjë përgjigje në lidhje me të pranë Komisionerit.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesi, rezulton se, ankuesi, z. K. H., është babai i shtetasit G. H., i datëlindjes 09.03.1993. Sipas shkresës datë 01.12.2024, të lëshuar nga Drejtoria

Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier, shtetasi G. K. H., është person me aftësi të kufizuara Nivel 2 (i moderuar), i vlerësuar me diagnozën: *Prapambetje mendore e moderuar*

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit, ankesën nr. 77 regj., datë 01.04.2025 kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Fier, duke pretenduar se djali i tij është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe ka kërkuar përfitimin e bonusit të dhjetorit si person me aftësi të kufizuara, referuar VKM-së Nr. 736, datë 27.11.2024 *“Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024”*.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se : *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një

justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Bazuar në nenin 4, të LMD, përcaktohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”*

Sipas nenit 32, të LMD, përcaktohet se: *“1. Komisioneri ka kompetencë:a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;.....3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Referuar nenit 33, të LMD, përcaktohet se: *“1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”*

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”*

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Bazuar në nenin 4, të LMD të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të LMD, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që ankuesi të legjitimohen si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të ketë një interes legjitim të drejtpërdrejtë.

Ankuesi pretendon se djali i tij është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe ka kërkuar përfitimin e bonusit të dhjetorit si person me aftësi të kufizuara, referuar VKM-së Nr. 736, datë 27.11.2024 *“Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024”*.

Në nenin 6, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “6. Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile....”. Ndërsa në nenin 10, përcaktohet se: “Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.”

Referuar dokumentacionit të depozituar nga ankuesi në mbështetje të pretendimeve të paraqitura në ankesën e tij, konstatohet se, djali i tij, shtetasi G. H., është i datëlindjes 09.03.1993. Pra, z. G. H., është 32 vjeç. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton që ai është madhor dhe nuk është përcjell pranë Komisionerit asnjë fakt apo dokument me anë të të cilit i është hequr apo kufizuar zotësia për të kryer veprime juridike. Në këtë kuptim, z. G. H., nuk rezulton t’i jetë hequr zotësia për të vepruar, e për rrjedhojë ai mund të depozitonte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në emër të tij ankesën objekt shqyrtimi. Pavarësisht këtij fakti, z. K.H., edhe pse është babai i shtetasit G. H., nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në emër të djalit, pa pëlqimin e tij.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese z. K. H., nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 77 regj., datë 01.04.2025, të paraqitur nga z. K. H., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

